



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 5282 / 11 Prot.

Pogradec, më 19.11.2021

VENDIM

NR. 89, DATË 18.11.2021

MIRATIMI I RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES, SIPAS NENIT 53, PIKA 5, LIGJI
139/2015

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi shqyrtoi me këshilltarët dhe miratoi propozimet e paraqitura si dhe pikat e rendit të ditës të njoftuara për vendimarrje në njoftimin për mbledhjen e datës 18.10.2021, në mbështetje të ligjit nr 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 54, gërma k, si dhe neni 97, pika 2 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

KËSHILLI I BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë rendin e ditës për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Pogradec sipas njoftimit bashkëlidhur
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT

Sotiraq MANGËRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 5282/9 Prot.

Pogradec, më 12. 11. 2021

LËNDA: Njoftim për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Pogradec

Z/Znj. _____

Të nderuar!

Ju njoftojmë se ditën e Enjte me datë 18.11.2021, ora 12:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Pogradec zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetari I Këshillit në bazë të ligjit 139/2015, neni 53 pika 4, me këtë rend dite :

1. **Projekt – vendim:** Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015.
2. **Projekt – vendim:** Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 19.10.2021 të Këshillit Bashkiak Pogradec
3. **Projekt – vendim:** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Tetor 2021.
4. **Projekt – vendim:** Një ndryshim në VKB nr.144 dt 24.12.2020, “Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2021”
5. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë Pogradec”
6. **Projekt – vendim:** Për një ndryshim në Vendimin nr 15, datë 01.03.2017, “Për miratimin e orareve dhe stacioneve për linjat rrethqytetëse”
7. **Projekt – vendim:** Për miratimin e kërkesës së familjes së z.Myfit Gega që do të vazhdojë procedurën e privatizimit të banesës shtetërore që ka mbetur e paprivatizuar.
8. **Projekt – vendim:** : Për miratimin e kërkesës së damiljes së z.Avni Hamzallari që do të vazhdojë procedurën e privatizimit të banesës shtetërore që ka mbetur e paprivatizuar.
9. **Projekt – vendim:** Për miratim të implementimit në rast aprovimi të projektit me titull “Struga dhe Pogradeci për promovimin e turizmit dhe trashëgimisë kulturore-COOLTOUR” në përgjigje të Programit Ndërkufitar Maqedoni e Veriut- Republika e Shqipërisë, nën alokimin e fondeve të IPA II 2018-2020”
10. **Projekt – vendim:** Për miratim të implementimit në rast aprovimi të projektit strategjik me titull “Liqeni i Ohrit, lidhja e dy vendeve drejt një destinacioni” në përgjigje të Programit Ndërkufitar Maqedoni e Veriut- Republika e Shqipërisë fondet IPA II 2018-2020”
11. **Projekt – vendim:** Disa shtesa, ndryshime dhe saktësime në vendimi i këshillit të bashkisë pogradec nr. 83, datë 19.10.2021, "Për fillimin e procedurave për transferimin në pronësi të bashkisë Pogradec të disa objekteve ushtarake të ndodhura në territorin e Bashkisë Pogradec, nga Ministria e mbrojtjes”, i kthyer nga institucioni i prefektit të qarkut korçë, me shkresën nr. 1003/2 prot, datë 29.10.2021.
12. **Projekt – vendim:** Për miratimin e planit të aktiviteteve dhe planit të konsultimeve publike të Këshillit të Bashkisë Pogradec për vitin 2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 BASHKIA POGRADEC
 KËSHILLI

- 13. **Projekt – vendim:** Për miratimin e shpenzimeve nga buxheti i Këshillit të Bashkisë Pogradec për vitin 2022
- 14. **Projekt – vendim:** Për dhënien e dakortësisë, për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor publik, të sipërfaqes pyjore prej 37,93 (tridhjetë e shtatë presje nentëdhjetë e tre) ha, e ndodhur në ekonominë pyjore Mokër 2, për shfrytëzimin me karrierë të mineralit hekur-nikel, në zonën minerare bari i bardhë (debrovë), nga shoqëria “Joal-06” shpk.

KRYETAR I KËSHILLIT
 Sotiraq MANGËRI

Shënim:

Mbledhjet e Komisioneve të Këshillit janë si mëposhtë:
Komisioni I Mandateve, Rregulloreve, Ceshjtëve Juridike, Qeverisjes së Mire, Administratës, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare, I Etikës, Konfliktit të Interesit, Standarteve dhe Apelimeve.
Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikeqyrjes Financiare, I Ekonomisë Vendore, Turzimit dhe Zhvillimit Rural,
Komisioni I Shërbimeve Publike, Transportit, Levizshmërisë Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve, I Zhvillimit Hapësor, Infrastruktura dhe Strehimit.
Komisioni I Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit, I Qeverisë Elektronike dhe Teknologjisë së Informacionit
Komisioni I Mireqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut, për Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin Europian.
Komisioni I Shëndetësisë, Veterinarisë Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, I Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të ujërave, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Biodiversitetit, ditën e Merkure, dt 17.11.2021, ora 14:30⁰⁰ për pikat 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13 të rendit të ditës, në Sallën e Këshillit Bashkiak.